

Strazbur, 9 korrik 2008

GVT/COM/II(2007)002

**KOMITETI KËSHILLUES PËR KONVENTËN KORNIZË PËR MBROJTJEN E
MINORITETEVE KOMBËTARE**

**KOMENTE TË QEVERISË SË “ISH REPUBLIKËS JUGOSLLAVE TË
MAQEDONISË” NË LIDHJE ME OPINIONIN E DYTË TË KOMITETIT
KËSHILLUES PËR IMPLEMENTIMIN E KONVENTËS KORNIZË PËR
MBROJTJEN E MINORITETEVE KOMBËTARE NGA “ISH REPUBLIKA
JUGOSLLAVE E MAQEDONISË”**

(pranuar në 5 shtatot 2007)

KOMENTE NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË LIDHJE ME OPINIONIN E KOMITETIT KËSHILLUES NGA 23 SHKURT 2007 PËR IMPLEMENTIMIN E KONVENTËS KORNIZË PËR MBROJTJEN E MINORITETEVE KOMBËTARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Komente të përgjithshme

Qeveria e Republikës së Maqedonisë i kushton kujdes të madh implementimit të Konventës kornizë për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare. Që nga miratimi i Opinionit të Komitetit këshillues në maj 2004 janë investuar shumë mundime në përmirësimin e pjesëmarrjes së personave që ju përkasin bashkësive etnike në të gjithë sferat e shoqërisë maqedonase. Ne jemi të lumtur të gjejmë referencat përkatëse për këta arritje në Opinionin e dytë të Komitetit këshillues të Republikës së Maqedonisë miratuar në shkurt 2007. Vlen të përmenden përparimet e bëra në gjithë spektrin social që ndër të tjera përfshin fushën e arsimit, përdorimit të gjuhëve, mediat, përmes luftës kundër diskriminimit dhe vendosjes institucionale për rritjen e pjesëmarrjes së personave që ju përkasin minoriteteve kombëtare në jetën publike në nivel qendror dhe lokal.

Përveç obligimeve që dalin nga KMK, korniza bazike e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në lidhje me vendosjen e politikës për minoritetet, vazhdon të jetë përkushtimi për implementimin e plotë të Marrëveshjes kornizë në legjislacion dhe praktikë në Republikën e Maqedonisë, që është një ndër synimet dhe detyrat kryesore politike të Qeverisë.

Me qëllim të përmirësimit të koordinimit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në tërësi, Qeveria ka formuar në trup iner sektoral në mes ministrive dhe institucioneve të ndryshme i cili ka intensifikuar punën e tij në vitin 2007. Ky trup ka për detyrë të koordinoj punën e të gjithë aktorëve të involvuar në implementimin e rekomandimeve të organeve të Kombeve të Bashkuara për Traktatin për të drejtat e njeriut dhe mekanizmave për vëzhgim të Këshillit të Europës, të pranuar gjatë vitit 2006 dhe 2007. Sidomos rekomandimet që kanë të bëjnë me implementimin e Konventës për mënjanimin e të gjithë formave të diskriminimit ndaj grave, Konventës për mënjanimin e të gjithë formave të diskriminimit racor dhe Marrëveshjes ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.

Për përmirësimin e të drejtave të minoriteteve kombëtare, në janar 2007 Qeveria e Republikës së Maqedonisë miratoi Strategjinë për përfaqësimin e drejtë të bashkësive që nuk janë shumicë. Strategjia parasheh disa masa dhe aktivitete për intensifikimin e përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të bashkësive. Për implementimin e Strategjisë është zhvilluar një plan veprimi. Me qëllim që puna e Sektorit për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit të bëhet më transparente dhe më e afërt për qytetarët është krijuar një web faqe në tre gjuhë (www.siofa.gov.mk). Gjithashtu, Qeveria miratoi vendimin për ngritjen e Sektorit në Sekretariat me numër më të madh të punësuar dhe me më shumë kompetenca.

Si rezultat i masave të ndërmarra përfaqësimi i personave që ju përkasin bashkësive në administratën dhe institucionet publike është rritur thelbësisht. Qeveria e Republikës së Maqedonisë vendosi të rrit Buxhetin shtetëror për 3,5 herë në vitin 2007 me qëllim të siguroj baza për përfaqësim më të mirë të të gjithë komuniteteve. Në janar 2007 përqindja e përgjithshme e përfaqësimit është 22,2% (16,9% shqiptarë etnik, 1,6% serbë etnik, 1,5% turqi etnik, 0,5 vllahë, 0,3 boshnjakë dhe 0,8% të tjerë).

Çështja për involvim më të madh në politikë dhe punët publike të personave që ju përkasin minoriteteve me numër më të vogël është nën shqyrtim nga ana e Parlamentit. Në këtë drejtim në punë e sipër është elaborim i zgjedhjeve adekuata në Kodin zgjedhor, që do të mundësojnë më shumë garanci për sigurimin e barazisë së plotë dhe efektive, në përputhshmëri me rekomandimet e përmbajtura në Rezolutën e Komitetit të ministrave (2005) 4 për implementimin e KMKK nga Republika e Maqedonisë.

Qeveria ka ndërmarrë shumë aktivitete që adresojnë problemet e **bashkësisë së romëve** në luftën kundër marginalizimit të tyre. Strategjia nacionale që ka këtë objektiv është sjellë dhe tashmë është operative.

Ministria e punës dhe politikës sociale në buxhetin e saj ka përkushtuar mjete financiare për implementimin e dy proekteve:

- integrim i fëmijëve romë në arsimin parashkollor (çerdhe).

Ky projekt është realizuar në 15 çerdhe në vend, duke filluar nga tetori i vitit 2006 deri në vitin 2008. Plani është që në periudhë prej dy vjet të integrohen 450 fëmijë prej moshës 4,5 vjet deri 6 vjet. Nga komuniteti rom planifikohet të punësohen 15 edukatorë që do të punojnë me këto fëmijë, kjo deri diku adreson problemin e punësimit.

Këtë vit, me rastin e 8 prillit – dita ndërkombëtare e romëve është promovuar nisma për hapjen e shkollës së mesem në gjuhën rome, që është e para e këtij lloji jo vetëm në Republikën e Maqedonisë, por edhe në regjionin më të gjërë.

Në janar të vitit 2007 Parlamenti i Republikës së Maqedonisë së bashku me anëtarët e Parlamentit europian, organizoi shqyrtim publik për çështjen e romëve me titull Mungesë e dijenisë apo vullnetit politik. Shqyrtimi u ndoq nga Kryetari i Parlamentit, Ministri i punëve të jashtme, Zëvendës ministri i arsimit, anëtarët e Parlamentit maqedonas, OJQ, partitë politike, organizatat ndërkombëtare, etj.

Në kuadër të Dekadës për përfshirjen e romëve, Qeveria e Maqedonisë ka përkrahur projektin për vendosjen e 8 qendrave informative rome në gjithë vendin. Qëllimi i këtyre qendrave është të shpërndajnë informata romëve etnik për realizim efektiv të drejtave të tyre dhe të lehtësojnë bashkëpunimin mes autoriteteve lokale dhe sektorit civil. Projekti ka filluar të jetë operativ në mars të vitit 2007 dhe përfshin komunën e Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Manastirit, Prilepit, Kumanovës, Shtipit dhe Delçevës. Kjo ka për qëllim të lidh bashkësinë e romëve me institucionet e nivelit lokal siç janë: Agencia e punësimit, Qendra për punë sociale, Instituti i mbrojtjes shëndetësore, Njësitë e vetëqeverisjes, Këshilltarët e arsimit në nivel lokal dhe Sektorin për planifikim urban në nivel lokal. Për implementimin e këtij projekti është bërë një lidhje partneriteti me 8 OJQ të romëve.

Mundësitë e romëve për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore janë prekur në komentet e dhëna nga Ministria e shëndetësisë.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka qenë shumë aktive në sigurimin e funksionimit të dialogut politik mes aktorëve të ndryshëm politik që ju përkasin bashkësive etnike. Dialogu është proces në vazhdimësi dhe rezultatet nga ai duhet të adresohen më tutje. Sidoqoft, me rëndësi është të përmendet se mekanizmat nacionale për mundësimin e dialogut politik po funksionojnë dhe janë në dispozicion të të gjithë subjekteve politike. Se si të gjindet një bazë e përbashkët në interesat e ndryshme e ndonjëhere edhe të kundërta, është pyetje që ka të bëjë me kulturën politike e jo me mungesën e legjislacionit të përshtatshëm dhe praktikës së përshtatshme administrative. Këto çështje nuk janë tipike për shoqërinë maqedonase por janë të njohura edhe për shumë vende tjera. Prandaj, kur ju qasemi dhe i analizojm, duhet të kemi shumë mirëkuptim dhe durim, duke patur parasysh specifikat e tyre dhe kohë që ato kërkojnë.

Komente të hollësishme të ministrive përkatëse dhe autoriteteve tjera kompetente janë këto:

Ministria e kulturës

Sa u përket vërejtjeve të paraqitura në Opinionin e Komitetit që përkrahja e promovimit të identitetit kulturor dhe trashigimisë kulturore të komuniteteve të ndryshme është e papërshtatshme, Ministria e kulturës thekson se sipas Ligjit për mbrojtjen trashigimisë kulturore i miratuar në mars të vitit 2004, trashigimia kulturore është e mbrojtur si vlerë fundamentale e Republikës së Maqedonisë dhe detyrueshëm është e mbrojtur në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Mbrojtja e trashigimisë kulturore është e udhëhequr nga vlerat e saj, rëndësia dhe niveli i brishtësisë, pavarësisht kohën, vendin dhe mënyrën e krijimit dhe kush e ka krijuar, kush zotëron apo ka në dispozicion trashigiminë, pastaj pavarësisht nëse ka karakter botëror apo fetar dhe pavarësisht cilit konfesion i përket.

Trashigimia kulturore në territorin e Republikës së Maqedonisë është një shprehje dhe konfirmim i vlerave universale që kanë egzistuar në këtë territor. Trashigimia kulturore është e mbrojtur sipas kriterëve të parapara me ligj. Gjërat që kanë rëndësi më të madhe shtetërore dhe kanë vlera universale për njerëzimin, historinë e tij, kulturën, artin, shkencën apo përparimin teknik, ose janë unike dhe janë karakteristike vetëm për një lloj krijimi në një periudhë të dhënë, ose janë karakteristike vetëm për një stil, ose gjëra që kanë patur ndikim të madh në zhvillimin e kulturës, artit, shkencës, zhvillimit teknik, ose janë dëshmi të ideve, besimeve, ngjarjeve të rëndësishme apo personaliteteve të famshëm janë të mbrojtura si trashigimi kulturore me rëndësi të veçantë. Kriter i vetëm për vendosjen e një gjëje nën mbrojtje është vlera e saj, pavarësisht nëse është i karakterit botëror apo fetar dhe pavarësisht faktit se cilit religjion i takon. Si rezultat i sundimit të gjatë Otoman, në Republikën e Maqedonisë ka ndërtime të shumta të ndërtuara sipas arkitekturës islamike, që paraqesin shembuj të shkëlqyer të artit islamik. Në periudhën e kaluar shumë ndërtime të tilla janë vendosur nën mbrojtje dhe janë ndërmarrë masa për ruajtjen dhe prezantimin e tyre.

Nxitjet e folklorit, traditave, zejeve të vjetra dhe vlerave të tjera të ngjajshme, si dhe aktivitetet e lira krijuese shumë shpesh paraqesin identitetin e një populli, kombi apo komuniteti. Për here të pare në legjislacionin e Maqedonisë, Ligji për mbrojtjen e trashigimisë kulturore paraqet kategorinë e trashigimisë kulturore shpirtërore. Kështu që, kufijtë e mbrojtjes janë zgjeruar edhe në gjërat jo materiale. Pra, Republika e Maqedonisë kushton kujdes të veçantë dhe përkrahë format e ndryshme të krijimtarisë që kanë të bëjnë me folklorin, zakonet dhe traditën e të gjithë bashkësive në vend.

Në lidhje me rekomandimet e bëra në paragrafin 74 dhe 75 të Opinionit të Komitetit këshillues vëmendja duhet drejtuar nga disa vepra dhe vendime politike. Domethënë, Qeveria ka vendosur të caktoj resurse thelbësore financiare për ripërtrijen e xhamijave, monumenteve kulturore, vendet fetare të bashkësive që si takojn shumicës. Në këtë drejtim janë marrur disa vendime, në mes të cilëve: vendim për ndërtimin e teatrit shqiptar në Tetovë, për themelimin e Institutit albanologjik në Shkup, për mbështetjen e krijimit të një monumenti kushtuar heroit kombëtar Skënderbeut në Shkup, si dhe vendim për financimin e librisë universitare në Tetovë.

Në fushën e legjislacionit, përkushtimi i Qeverisë për të dhënë mbështetje në promovimin e identitetit kulturor të bashkësive të ndryshme është transponuar në amendamentet e Ligjit për festat shtetërore. Me ndryshimet e bëra festat fetare dhe festat e bashkësive jo shumicë (shqiptarë, turqi, serbë, romë, vlllehë, boshnjakë dhe çifutë) janë shpallur si festa shtetërore.

Me nismën e Kryeministrit dhe si mënyrë për të kontribuar në përpjekjet ndërkombëtare në promovimin e dialogut mes kulturave dhe religjioneve, Qeveria e

Republikës së Maqedonisë do të organizoj Konferencë botërore për dialogun mes religjioneve dhe civilizimeve, që planifikohet të mbahet në Ohër prej 26 deri më 28 tetor të vitit 2007.

Ministria e punëve të brendshme

Dokumentet e identifikimit paragrafët – 20, 131, 132, 133

Në kontekst të zbatimit të procedurës së lëshimit të pasaportës, duke filluar nga plotësimi i kërkesës deri te shtypja e formularëve dhe shkruarja e të dhënave personale në pasaportë, egziston respektim i plotë i procedurave ligjore që rregullojnë të drejtën e përdorimit të gjuhës dhe alfabetit nga qytetarët të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshëm nga gjuha maqedonase, ashtu siç është rregulluar në ligjet përkatëse.

Nga dhjetori i vitit 2004, ka pasaporta të lëshuara që në tekst përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit qirilik ka të shtypur edhe gjuhën dhe alfabetin shqip, dhe kjo vlen edhe për të dhënat personale të shkruara.

Nga 2 prill i vitit 2007, nën projektin Dokumente të reja personale, qytetarët që flasin gjuhë tjetër nga gjuha zyrtare (serbë, boshnjakë, turqi dhe vllahë) me kërkesë të tyre mund t'iu shtypen emrat dhe mbiemrat e tyre në pasaportë edhe në gjuhën e tyre.

Minoriteteve kombëtare u janë lëshuar dokumentet personale – pasaportat, me kërkesën e tyre, me emër dhe mbiemër në gjuhën dhe alfabetin e tyre.

Në lidhje me lëshimin e dokumenteve të identifikimit, ligjet që rregullojnë të drejtën e personave që flasin një gjuhë zyrtare tjetër nga gjuha maqedonase të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre zbatohen plotësisht.

Tani në Republikën e Maqedonisë janë lëshuar dokumente identifikimi që janë shtypur në gjuhën maqedonase dhe alfabetin qirilik edhe në gjuhën dhe alfabetin shqip.

Sipas projektit të ri për dokumentet e identifikimit personal dhe zbatimit të neneve të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për sigurin në qarkullimin rrugor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 19/2007), prej 1 tetor të vitit 2007, do të ketë kushte të formuluar teknike për lëshimin e liçencës për vozitje, ku emri personal përveç në gjuhën maqedonase dhe alfabetin qirilik, në kërkesë të qytetarit plotësisht do të shtypet edhe në gjuhën dhe alfabetin që përdoret nga qytetari.

Neni 11, paragraf 130

Dokumentet personale të identifikimit iu lëshohen qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në bazë të të dhënave të marrura nga Regjistri i të lindurve. Në rast se qytetarët kërkojnë të ndryshojnë emrin e tyre personal, ose vetëm emrin apo vetëm mbiemrin, ato mund të plotësojnë kërkesë sipas Ligjit për emrin personal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.8/95) dhe mund të ndryshojnë emrin e tyre sipas dëshirës, poqese janë plotësuar gjithë kushtet e parapara në Ligjin e thënë. Nënvizohet që ligji nuk parasheh ndalime sa i përket zgjedhjes së emrit personal, përveç asaj që emri nuk duhet të cenoi moralin publik.

Sa i përket transliterimit të emrave personal, është theksuar që transliterimi bëhet sipas rregullave ortografike të gjuhës maqedonase, do të thotë të gjuhës në të cilin transliterimi është bërë.

Për elaborimin e rezultateve nga cikli i parë dhe nga gjendja e tanishme e përdorimit të gjuhëve nga ana e personave që iu përkasin bashkësive, është e nevojshme të bëhen përshtajet e duhura terminologjike, në përputhshmëri me dispozitat ligjore që rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me dokumentet e identifikimit të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, sidomos në dritë të Ligjit për dokumentet e identifikimit. Kjo nënkupton harmonizim adekuat të vendimeve ligjore të dhëna në tekstin, me dispozitat ligjore të zbatueshme që rregullojnë këtë materie.

Ministria e shëndetësisë

Ministria e shëndetësisë nuk pajtohet me konkluzionin e përmbajtur në paragrafin 57 të Opinionit, në të cilin nënvizohet se mundësitë e romëve për shfrytëzimin e shërbimeve të ndihmës sociale dhe kujdesit shëndetësor janë problem serioz, gjithashtu duke nënvizuar edhe raportimin e shpesht të problemeve serioze në marrjen e tretmanit në spitale dhe segregimin e tyre në spitale, mungesën e mundësive për marrje të medikamenteve dhe pamundësinë e pagesës së shërbimeve, dhe referon si mëposhtë:

- Të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë pavarësisht përkatësisë së tyre etnike në mënyrë të barabartë gëzojnë të drejtë e përkujdesit shëndetësor, në përputhshmëri me dispozitat e nenit 3, paragraf 1 të Ligjit për mbrojtjen shëndetësore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/91, 46/93, 55/95, 10/04, 84/2005, 111/2005, 65/2006 dhe 5/2007) sipas të cilit "Secili ka të drejtën e mbrojtjes shëndetësore".

- Barazia e qytetarëve në fushën e kujdesit shëndetësor më tutje është e paraparë në dispozitat e nenit 2, paragraf 2 të Ligjit për sigurim shëndetësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 25/00, 34/00, 96/00, 50/01, 11/02, 31/03, 84/05, 37/2006 dhe 36/2007) sipas të cilit "Sigurim i detyrueshëm shëndetësor është vendosur për të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë me qëllim që të siguroj shërbime shëndetësore dhe kompensime monetare të bazuara në parimin e mbulimit më të gjerë, solidaritetit, barazisë dhe përdorimit efektiv të pajisjeve sipas kushteve të vendosura në këtë Ligj dhe akteve nënligjore të miratuara bazuar në këtë Ligj."

- Ligji për mbrojtjen shëndetësore parasheh miratimin e Programeve vjetore për mbrojtje shëndetësore të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë. Aktivitetet e vendosura në këto programe janë implementuar për gjithë popullatën pavarësisht religjionit, kombësisë apo ndonjë përkatësie tjetër apo statusit të sigurimit. Në përpilimin dhe implementimin e aktiviteteve nga programet përqëndrim të veçantë i kushtohet arritjes së një mbulimi më të mire të popullatës së pambrojtur, populates në vende rurale dhe kategorive në rrezik. Në kontekst të implementimit të aktiviteteve, mbikëqyrja e epidemiologjisë sanitare, kontrolli i cilësisë së ujit për pije, dezinfektimi dhe dezinfektimi i disa vendeve, edukimi shëndetësor në bashkëpunim me OJQ-të, puna e motrave medicinale që bëjnë vizita për zbulimin e fëmijëve të paimunizuar janë me rëndësi të veçantë.

- Në komunën e Shuto Orizari, e cila është kryesisht e banuar nga popullata e romëve, me mbështetje të Ministrisë së shëndetësisë dhe organizatave ndërkombëtare është hapur Shërbimi miqësor ndaj të rinjve i cili ofron preventivë shëndetësore dhe shërbime edukative falas për të rinjtë e kësaj komune.

- Nën programin HIV/AIDS dhe Tuberkulozës, aktivitete posaçërisht të përpiluara janë ndërmarrë me përqëndrim në popullatën e romëve, financiarisht të mbështetura nga një grant i Fondit global.

- Në këtë drejtim duhet bërë referencë për atë që në kodekset deontologjike të asociacioneve profesionale të mjekëve, dentistëve dhe farmaceutëve të Republikës së Maqedonisë thuhet që në angazhimin e profesionit të mjekut, dentistit, apo farmaceutit, mjekët, dentistët dhe farmaceutët e Republikës së Maqedonisë janë të detyruar të mbrojnë traditën e ndershme dhe fisnike të profesionit të tyre dhe në performimin e detyrave profesionale ato nuk do të bëjnë dallim në baza gjinore, moshe, përkatësie etnike, race, përkatësie politike, orientimi seksual, invaliditet, dhe pozite sociale dhe ekonomike.

- Sipas të dhënave të përmbajtura në Raportin e Avokatit të popullit për vitin 2006, nuk ka patur asnjë kërkesë të plotësuar për diskriminim të romëve nga personeli i kujdesit shëndetësor.

Këshilli emitues

Në mbledhjen e mbajtur në 10 maj të vitit 2007, ku u elaboruan komentet e përmbajtura në Opinionin e dytë për Republikën e Maqedonisë, Këshilli emitues erdhi në përfundim se konkluzionet që përmban Opinionin i dytë në lidhje me aksesin e komuniteteve etnike në media saktë reflektojnë situatën e tanishme nga aspekti i kontrollit dhe se rekomandimet e Komitetit këshillues më shumë kanë të bëjnë në rradhë të parë me qendrat e mediave dhe me profesionistët e mediave.

Komisioni për marrëdhëniet me komunitetet dhe grupet fetare

E drejta e manifestimit të lirisë së religjionit dhe besimit është e rregulluar në nenin 9, 16 dhe 19 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Sipas dispozitave të nenit 9 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, qytetarët janë të barabartë në liritë dhe të drejtat e tyre pavarësisht gjinisë, racës, ngjyrës së lekurës prejardhjes kombëtare dhe sociale, besimeve politike dhe fetare, gjendjes pronësore dhe sociale.

Neni 16 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë garanton lirinë e bindjes personale, vetëdijes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit.

Neni 19 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë garanton lirinë e religjionit.

“Secilit i është garantuar e drejta e shprehjes së besimit në mënyrë të lirë dhe publike, individuale ose me të tjerë.”

Sipas amendamentit VII të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë “Kisha ortodokse maqedonase, si dhe Bashkësia e religjionit islam në Maqedoni, Kisha katolike, Kisha evangjeliste methodiste, Bashkësia hebreje dhe bashkësitë dhe grupet tjera religjioze janë të ndara nga shteti dhe janë të barabarta para ligjit.

Kisha ortodokse maqedonase, si dhe Bashkësia e religjionit islam në Maqedoni, Kisha katolike, Kisha evangjeliste methodiste, Bashkësia hebreje dhe bashkësitë dhe grupet tjera religjioze janë të lira në themelimin e shkollave dhe organizatave tjera shoqërore dhe bëmirëse, duke ndjekur procedurën e rregulluar me ligj

Sipas dispozitave të cituara më lartë të Amendamentit VII të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë bashkësitë fetare dhe grupet fetare mundin lirisht të themelojnë organizata shoqërore dhe bëmirëse, duke ndjekur procedurën e rregulluar me ligj.

Statusi i bashkësive fetare dhe themelimi i grupeve fetare është i rregulluar me Ligjin për bashkësitë fetare dhe grupet fetare (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 35/97).

Nuk egziston paqartësi apo konfuzion mes personave që ju përkasin minoriteteve në lidhje me procedurën e regjistrimit të bashkësive fetare.

Në Republikën e Maqedonisë është e garantuar liria e shprehjes së besimit dhe përkatësisë së bashkësisë apo grupit fetar. Sipas nenit 4 të Ligjit për bashkësitë fetare dhe grupet fetare është e ndaluar të pengohen qytetarët në ushtrimin e lirive të tyre fetare.

“Sipas kësaj është e ndaluar kërcënimi me forcë apo pengimi në çfarëdo mënyre i qytetarëve të bëhen apo të jenë anëtarë të një bashkësie fetare apo një grupi fetar.

Është e ndaluar të detyrohen me forcë qytetarët të marrin apo mos të marrin pjesë në ritet fetare dhe llojet tjera të të shprehurit të besimit.

Qytetarëve nuk mundet t’ju merren të drejtat që i kanë me Kushtetutë dhe ligj për bindjen e tyre fetare, përkatësinë në një bashkësi fetare apo grupi fetar, performimin apo pjesëmarrjen në përformim të riteve fetare apo llojeve tjera të shprehjes së besimit”.

Gjykata kushtetuese e Republikës së Maqedonisë ka miratuar dy Vendime që shfuqizuan nenet e Ligjit për bashkësitë fetare dhe grupet fetare:

Nenin 3, paragraf 1, neni 10, neni 11, paragraf 2, neni 13 dhe 14 dhe neni 22, paragraf 2 si dhe neni 19 dhe 23.

Dy vendimet e Gjykatës kushtetuese që shfuqizuan disa dispozita të Ligjit për bashkësitë fetare dhe grupet fetare nuk do të thotë amendamente të Ligjit – por thjesht nënkupton që disa dispozita janë të fshira. Në fakt Gjykata kushtetuese sipas Rregullores për procedurën e Gjykatës kushtetuese nuk ka të drejtën të bëjë amendamente të Ligjit, por mbi një inicijative të dorëzuar vlerëson nivelin e harmonizimit të një ligji me Kushtetutën, dhe në qoftë se konkludohet që ligji është në kundërshtim me Kushtetutën atëherë Gjykata shfuqizon disa nene apo gjithë Ligjin.

Në Republikën e Maqedonisë bashkësitë fetare dhe grupet fetare nuk janë të regjistruara sipas grupit të minoriteteve që ju përkasin, por sipas besimit të tyre fetar dhe llojeve të shprehjes së besimit.

Sipas kësaj, këta dispozita nuk janë aspak diskriminuese sidomos në dritë të faktit që Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë në nenin 8, paragraf 1, nënparagraf 1, e vendos si një ndër vlerat themelore sipas cilës “liritë dhe të drejtat themelore e individëve dhe qytetarëve të njohura në të drejtën ndërkombëtare dhe të vendosura në Kushtetutën si një nga vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë “, që gjithashtu përfshin edhe lirinë e mendimit, vetëdijes dhe religjionit, përderisa kjo liri përfshin lirinë e shprehjes së besimit dhe bindjes në mënyrë individuale apo në bashkësi me të tjerë, publikisht apo privatisht, përmes shërbimeve fetare, mësimëve fetare, predikimeve, riteve dhe ceremonive fetare.

Potencohet se pritet të miratohet një ligj i ri më demokratik dhe liberal për statusin juridik të kishës, bashkësive fetare dhe grupeve fetare. Ligji është hartuar në konsultime transparente me OSBE/ONDNJ dhe Komisionin e Venedikut, duke mbajtur llogari për specifikat maqedonase dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë.

Në lidhje me përdorimin e gjuhëve të minoriteteve në komunikim me autoritetet publike dhe në autoritetet publike – Neni 10 i Konventës kornizë

Me qëllim të rritjes së përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të personave që ju përkasin minoriteteve por edhe me qëllim të përmirësimit të përdorimit të gjuhëve të minoriteteve, në fund të vitit 2006 Qeveria vendosi të punësoj 99 përkthyes në gjuhën shqipe në administratën publike dhe administratën në gjykata. Proçesi vazhdoi edhe në vitin 2007 duke zgjeruar mundësitë për punë edhe në administratën shtetërore për më shumë se 200 administrator shtetëror që ju përkasin bashkësive të minoriteteve. (Referojmë në rekomandimet e përmbajtura në paragrafin 129 dhe 229 të Opinionit të dytë të Komitetit këshillues)

Hartimi i ri i Rregullores për punën e Kunvedit përmban propozim për përmirësimin e përdorimit të gjuhëve të minoriteteve që fliten nga së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në punën e komisioneve të Parlamentit. Ky propozim paraqet një përparim në krahasim me normat e përmbajtura në Rregulloren për punën e Kuvendit maqedonas të vitit 2002.

Në lidhje me masat në fushën e arsimit dhe në sigurimin e mundësive të barabarta për hyrje në arsim – neni 12 i Konventës kornizë

Në fushën e arsimit, Ligj për arsimin fillor është ndryshuar në drejtim të prezentimit të arsimit të detyrueshëm 9 vjeçar dhe orëve fakultative të edukimit fetar. Qëllimi është të promovohen vlerat universale në të cilat bazohen të gjithë religjionet dhe të zhvillohet mirëkuptimi qytetar në mes nxënësve, por gjithashtu të mundësohet zhvillim i identitetit të tyre individual fetar.

Në prill të vitit 2007 janë bërë amendamente të Ligjit për arsimin e mesëm duke shëndruar arsimin e mesëm në të detyrueshëm dhe pa pagesë. Qëllimi është të përmirësohet niveli i arsimimit të të gjithë qytetarëve, dhe posaçërisht i atyre që ju përkasin bashkësive të minoriteteve, të cilët në të kaluarën kanë patur përvojë me akses të limituar në gjithë profilet e arsimit të mesëm në gjuhën e tyre. Me këta përparime, objektiva e Qeverisë së Maqedonisë është të përforëtoj kapacitetin njerëzor, të zvogëloj papunësinë, të rris kohezionin social dhe të eliminojë padrejtësitë sociale dhe diskriminimin.

Konkluzion

Qeveria e Republikës së Maqedonisë shumë lartë vlerëson aktivitetet e Komitetit këshillues në procesin e vëzhgimit të zbatimit të Konventës kornizë dhe konsideron se plotësimi i obligimeve nga Konventa duhet të jetë proces i vazhdueshëm pan European.